

# TIRANIA TECH OPEN

— 2-3 NËNTOR 2023 —

EDICIONI I 2TË



## TIRANA TECH OPEN 2023:

Një event 2-ditor kombëtar dhe ndërkombëtar, që sjell së bashku sipërmarrës, investitorë, institucione, biznese inovative, mediat dhe të gjithë të apasionuarit e teknologjisë. Ai synon të bashkojë pjesëmarrësit dhe palët e interesuara për të eksploruar mundësitë e biznesit, për të modeluar sëbashku të ardhmen dhe për t'ju përgjigjur sfidave më të ngutshme teknologjike.



## PARTNERITET

Me pjesëmarrjen e 100 sipërmarrjeve, mes të cilave startup, korporata dhe biznese që operojnë në vend, së bashku me institucione qeveritare, investitorë, institucione donatore, universitete dhe studentë, kjo do të jetë një platformë e paçmuar, duke ftuar mbi 3000 vizitorë gjatë eventit!

Eventi do të mirëpresë pjesëmarrjen e kompanive të shquara në rajon (nga Bosnjë-Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia), që do të ndajnë historitë e tyre të suksesit dhe do të eksplorojnë mundësi të reja bashkëpunimi. Expocity Albania do të mundësojë një event cilësor me standarde ndërkombëtare, duke siguruar pajisje dhe shërbime sipas nevojës dhe duke ofruar një ekip ekspertësh dhe specialistësh të përkushtuar.



**TTO ZONES** synojnë të krijojnë një atmosferë frymëzuese dhe të sigurojnë një përvojë të vazhdueshme për pjesëmarrësit. Aty do të gjeni gjithçka që ju nevojitet në një vend të vetëm: demonstrime teknologjike dhe zgjidhje nga ekspozuesit tanë, diskutime dhe histori suksesi nga bizneset, institucionet dhe startup-et, si dhe salla networking për të krijuar lidhje të vlefshme.

**FORUM ZONE** është krijuar si një mundësi për të marrë pjesë në panele diskutimi, për të mësuar nga historitë e suksesit dhe për të trajtuar tematika të tilla si: sfidat e arsimit dhe punësimit në industrinë e teknologjisë, investimet në teknologji, inovacion dhe sipërmarrje. Do të adresohet nevoja për të vlerësuar dhe përmirësuar sistemin arsimor, për të kuptuar ndikimin e madh të teknologjisë në biznes, si dhe investimi në fazat e hershme dhe nxitja e startup-eve dhe inovacionit. Një vend ku të gjitha palët e interesuara mund të angazhohen dhe të vlerësojnë mënyra të reja të të menduarit dhe të vepruarit, në mënyrë që të gjenden mundësi të reja dhe të transformohet e ardhmja.

**EDU ZONE** është zona e dedikuar për të rinjtë entuziastë, që janë të apasionuar pas përdorimit të teknologjisë dhe aplikimeve të saj. 100 studentë, përfaqësues të universiteteve dhe shkollave profesionale, do të ndjekin një workshop 2-ditor nën drejtimin e mentorëve të specializuar. Në ceremoninë e mbylljes do të jepen çmime të veçanta për ekipet fituese nga seminari. Gjithashtu, prezantimet tematike në Forume Zone gjatë tri ditëve të eventit, do të jenë burime të dobishme njohurish dhe frymëzimi për studentët. Kjo platformë do të krijojë mundësi kontakti me kompani të ndryshme, duke sjellë kështu edhe mundësi të ndryshme trajnimi dhe/ose punësimi.

**B2B ZONE** është projektuar që të jetë e përbërë nga një zonë e hapur për takime dhe nga një zonë me rezervime para-prake. Ajo do të jetë e disponueshme për bizneset pjesëmarrëse të niveleve të ndryshme (përfshirë edhe iniciativat e reja startup), duke synuar të nxisë shkëmbimin e njohurive, informacioneve mbi zhvillimet më të fundit, rezultateve përkatëse dhe produkteve dhe shërbimeve, si dhe të mundësojë fusha të reja bashkëpunimi ndërmjet palëve.

Media Zone do të përfshijë një kënd për fotografi falas dhe stende mediatike për intervista ekskluzive: të ftuar, partnerë, sponsorë, histori suksesi, etj.



# TIRANA ECHOPEX

— 2-3 NËNTOR 2023 —

EDICIONI I 2TË



## STENDA STANDARTE

Emrin e printuar të kompanisë  
 Panele MDF, 2.5 m lartësi  
 Tapet një përdorim  
 1 Tavolinë, 2 karrige  
 Energji elektrike dhe ndriçim  
 Wi-Fi

**ÇMIMI: 80 €/m<sup>2</sup> (PA TVSH)**



# TIRANA TECH OPEN

## KUSHTET E PJESEMARRJES SI PARTNER EVENTI:

SILVER PARTNER	GOLD PARTNER	PLATINIUM PARTNER	PAKETAT
€ 5,000	€ 7,000	€ 10,000	PAKETAT E ÇMIMEVE
35 m <sup>2</sup>	50 m <sup>2</sup>	70 m <sup>2</sup>	Tenda me pajisjet
1 person	1 person	1 person	Alokimi i pjesëmarrjes në konferencë
✓	✓	✓	Konsiderimi i pozicionit të stendës
		1 pg	Reklamim në katalogun e panairit, kopertina ballore Faqe e brendshme
	1 pg		Reklamim në katalogun e panairit, faqja e pasme e kopertinës jashtëi
1 pg			Reklamim në katalogun e panairit, faqja e pasme e kopertinës brenda
		✓	Reklamim me dy faqe në Katalogun e Panairit, faqe e brendshme
✓	✓	✓	Integrimi i logos së kompanisë në të gjitha materialet e printuara të panairit
✓	✓	✓	Kompania juaj përmendet në fjalimin e inaugurimit
		✓	Mundësia për të reklamuar banner-in e kompanisë në fasadën e Expocity
		✓	Prezantim si Sponsor Kryesor në fushatën e marketingut
✓	✓	✓	Logoja e kompanisë në fushatën e marketingut
		✓	Logoja e sponsorit në reklamimin e panairit në një nga revistat profesionale rajonale
✓	✓	✓	Logoja e kompanisë në buletinin e panairit tregtar
		✓	Broshurat e kompanisë brenda dosjeve të konferencës/workshop-it
✓	✓	✓	Njoftimi editorial për shtyp i dërguar në listën e shpërndarjes së shtypit rajonal
		✓	Kompania juaj përmendet në artikujt mediatikë për panairin tregtar
	✓	✓	Logoja e kompanisë në ftesa të personalizuara
✓	✓	✓	Logoja e kompanisë në fasadën e banner-it për vizitorët

PAKETA PARTNERE



Expocity Albania është organizues i Panairove dhe Konferencave Kombëtare dhe Ndërkombëtare, i çertifikuar nga UFI, specializuar në organizimin dhe zhvillimin e panairove, ekspozitave dhe eventeve të ndryshme të biznesit, drejtuar tregut vendor dhe atij ndërkombëtar.

Expocity Albania ju ofron pjesëmarrësve në këto aktivitete një strukturë dhe infrastrukturë të plotë, bashkëkohore dhe të plotësuar me të gjitha lehtësitë dhe stafin e nevojshëm.

Këto bashkë me 5'500 m<sup>2</sup> hapësirë të brendshme, 7'000 m<sup>2</sup> hapësirë të jashtme, 800 vende parkimi, e plotësojnë Expocity Albania si platformën më komplekse dhe më të përshtatshme për realizimin me sukses të këtij lloji komunikimi në Shqipëri.

 +355 67 770 0077

 [info@expocity.al](mailto:info@expocity.al)

 [www.expocity.al](http://www.expocity.al)

